

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 31 MARS 2022

Siç e thatë me të drejtë, ne jemi njohur me rendin e ditës të nxjerrë nga Kryetarja e Kuvendit dhe konstatoj se janë futur prej saj edhe dy projektvendime, që lidhen eventualisht me emërimin e dy anëtarëve në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Unë kam një kërkesë për një shtesë në rendin e ditës, pra që të futet sot kërkesa, e cila përmban projektvendimin për shqyrtimin e kandidaturës të zotit Mateo Spaho, i cili është kandidat për në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Të gjitha procedurat teknike të mbledhjes së nënshkrimeve janë depozituar, po ashtu edhe kërkesa për t'u shtuar në rendin e ditës. Besoj se kjo kërkesë do të duhet të futet sot në rendin e ditës, jo vetëm kaq, por do të kërkoja nga kushdo që, për hir të balancës apo ruajtjes integre të vlerësimit që duhet të kemi për Bankën e Shqipërisë, të merret parasysh jo vetëm duke u futur në rendin e ditës, por edhe duke u votuar, atëherë kur do të votohet, për të garantuar pikërisht mbështetjen konsensuale të një prej institucioneve më të rëndësishme, siç është Banka e Shqipërisë.

Për këtë arsye kërkoj: futjen e saj në rendin e ditës, eventualisht edhe votimin e saj. Faleminderit!